

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**PKL.-KZZ. Nr. 23/2011**  
**27 dhjetor 2011**  
**Prishtinë**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë prej  
Gjyqtarit të EULEX-it Charles L. Smith III. si kryetar i kolegjit,  
Gjyqtarit të EULEX-it Martti Harsia dhe  
Gjyqtarit të Gjykatës Supreme Salih Toplica si anëtarë të kolegjit,

Në prani të Zyrtarit ligjor të EULEX-it Holger Engelmann, duke vepruar në cilësi të procesmbajtësit, në seancën e mbajtur më 27 dhjetor 2011,  
në lëndën penale kundër:

**E H**, emri i babait **T**, mbiemri i vajzërisë së nënës **V C**, i lindur më **X X X** në fshatin **X X X**, komuna e Prizrenit, me vendbanim në **X X X**, rruga **X X X**, komuna e Prishtinës, Kosovë, shqiptar i Kosovës, i martuar, baba i **X X X** fëmijëve, **X X X**, me gjendje ekonomike mesatare, numri i letërnjoftimit **X X X**,

I akuzuar sipas aktakuzës PP. Nr. 1916/09, të paraqitur nga Prokurori Publik Komunal në Prizren më 20 gusht, për veprat penale **Marrje e ryshfetit** sipas nenit 343 paragrafit 1 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tani e tutje KPPK);

I shpallur fajtor për veprën e lartpërmendur penale dhe i dënuar me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) viteve dhe me gjobë prej dhjetëmijë (10,000) Euro me aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Komunale në Prizren P.351/10, të datës 14 korrik 2010, dhe me aktgjykimin e shkallës së dytë të Gjykatës së Qarkut në Prizren KP.227/10, të datës 22 tetor 2010.

Duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së avokatit mbrojtës **Y O** në emër të pandehurit **E H** kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit P.351/10, të datës 14 korrik 2010, të vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren KP.227/10, të datës 22 tetor 2010.

Lëshon këtë:

### **AKTGJYKIM**

**Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit E H kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Prizrenit P.nr. 351/2010, të datës 14 korrik 2010, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren KP.nr. 227/2010, të datës 22 tetor 2010, REFUZOHET SI E PABAZUAR.**

### **ARSYETIM**

#### **I. Historia e procedurës**

Me aktakuzën PP. nr. 1916/09, të paraqitur nga Prokurori Komunal në Prizren më 20 gusht 2009, i pandehuri është akuzuar për veprën penale **Marrje e ryshfetit** në shkelje të nenit 343 paragrafit 1 të KPPK-së.

I pandehuri është dënuar me aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Komunale në Prizren, P. Nr. 351/2010, të datës 14 korrik 2010, për veprën e lartpërmendur penale dhe është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) viteve dhe me gjobë prej 10,000 Euro.

Pas ankesës së të pandehurit të paraqitur më 17 shtator 2010 nga avokatët e tij mbrojtës, Gjykata e Qarkut në Prizren me aktgjykimin KP. Nr. 227/2010, më 22 tetor 2010, ka refuzuar ankesën dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër dy aktgjykimeve, avokati mbrojtës Y O në emër të pandehurit ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë më 27 janar 2011.

Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) ka paraqitur përgjigjen më 22 prill 2011, me të cilën propozon që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

## **II. Gjetjet e Gjykatës Supreme**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pranueshme, por e pabazuar.

### **1. Pranueshmëria e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është paraqitur pranë Gjykatës kompetente sipas nenit 451 paragrafit 3 dhe nenit 453 të KPPK-së, dhe brenda afatit kohor të përcaktuar me nenin 452 paragrafit 3 të KPPK-së.

### **2. Procedurat e ndjekura nga Gjykata Supreme**

Gjykata Supreme ka vendosur në seancë siç është e përcaktuar me nenin 454 paragrafin 1 të KPPK-së. Palët nuk janë njoftuar lidhur me seancën, pasi që sipas neneve 451 deri në 460 të KPPK-së, Gjykata Supreme nuk është e obliguar që t'i njoftoj palët.

### **3. Lidhur me meritat e Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë**

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë pohon shkelje të ligjit penal dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale duke propozuar anulimin e aktgjykimeve të mëhershme dhe kthimin prapa të lëndës në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

I pandehuri pretendon se nuk kishte marrë para, se nuk kishte për qëllim nxjerrjen e aktgjykimit të kundërligjshëm, se nuk kishte tentuar të nxirrte aktgjykimin e kundërligjshëm edhe pse kishte mundësi për të bërë diçka të tillë, prandaj familja A kishte bërë komplot duke ia ngrehur kurthin atij (të pandehurit). Ai kundërshton këtë duke pohuar se regjistrimet audio vizuale kanë qenë të fabrikuara, pastaj që standardi i gjykatës për vlerësimin e pranueshmërisë (Neni 170, 171 i KPPK-së) ka qenë i gabuar dhe se të njëjtat është dashur të vërtetohen nga ndonjë ekspert para se të pranoheshin si prova. Ai po ashtu pohon se deklaratat e dëshmitarëve B P dhe R A bazohen në thashetheme.

Propozimi konstaton se gjykata e shkallës së parë kishte refuzuar gabimisht kërkesën e të pandehurit për leximin e aktgjykimit në lëndën penale kundër vëllezërve A dhe për shqyrtimin e anëtarëve të trupit gjykues.

Të gjitha këto argumente bien nën kategorinë e “vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike”, i cili sipas Nenit 456 të KPPK-së nuk mund të kundërshtohet përmes një Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë.

I pandehuri kundërshton mënyrën si është zhvilluar procedura në shkallën e dytë dhe konstaton se gjykata ka pasur paragjykime.

Gjykata konstaton se ky argument është dashur të ngrihej para mbylljes së procedurës në fjalë. Në kuadër të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë një argument i tillë nuk mund të ngrihet më.

Kërkesa po ashtu pohon se aktgjykimi i shkallës së parë është në kundërshtim me veten, në mënyrë specifike lidhur me shumën e parave të pranuar nga i pandehuri, e cila shumë pohohet se mbetet e paqartë. Sipas të pandehurit, është gjithashtu e paqartë se për çfarë arsye i pandehuri nuk kishte nxjerrë aktgjykimin e kundërligjshëm në dobi të vëllezërve A, edhe pse kishte mundësinë për një gjë të tillë.

Gjykata Supreme konstaton se çështjet e ngritura më lart janë të parëndësishme dhe nuk mund të përbëjnë shkelje të ligjit penal. Aktgjykimi i Gjykatës Komonale të Prizrenit është i qartë lidhur me faktin se i pandehuri kishte pranuar para në shkëmbim të premtimit për të kryer një kryerje zyrtar.

Aktgjykimi i shkallës së parë deklaroi se i pandehuri kishte pranuar përmes A Z të holla të gatshme në shumën prej së paku 53000 euro dhe më vonë edhe shuma të tjera. Nuk kërkohet që të përcaktohet shuma e saktë e përfitimeve të pranuar me qëllim të kryerjes së veprës penale të Marrjes së ryshfetit sipas Nenit 343, par. 1 të KPK-së. Është legjitime që të lihet e hapur çështja e shumës së saktë të parave të pranuar më vonë. Gjykata nuk sheh ndonjë kundërshti lidhur me shumën e parave.

Aktgjykimi i kundërshtuar është po ashtu mjaft i qartë lidhur me çështjen e kryerjes së aktit zyrtar. Dispozita e Nenit 343 të KPK-së nuk kërkon kryerjen e aktit zyrtar. Vepra penale kryhet atëherë kur kryerësi pranon paratë me qëllimin për ta kryer të njëjtën.

I pandehuri sugjeron që dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i paqartë.

Nga konteksti, gjykata konstaton se në të vërtetë i njëjti është duke e kundërshtuar dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së dytë. Dispozitivit të aktgjykimit në fakt i mungon një formulim me të cilin vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë.

Gjykata Supreme në vendimet e saj të mëhershme vazhdimisht ka përsëritur nevojën për interpretimin e vendimeve gjyqësore në mënyrë të plotë dhe kuptimplotë dhe se dispozitivi duhet të lexohet së bashku me arsyetimin.

Në lëndën kundër L. Xh. <sup>1</sup> gjykata shkruante:

*“...vetëm në qoftë se dispozitivi mbetet i pakuptueshëm apo i paqëndrueshëm edhe pas leximit të tij me arsyetimin, i njëjti mund të shpallet i kundërligjshëm ...”*

Po qe se lexohet së bashku me arsyetimin, i njëjti mbetet absolutisht i qartë se Gjykata e Qarkut të Prizrenit ka dashur të refuzonte ankesën ndaj aktgjykimit të shkallës së parë si të pabazë dhe ta vërtetonte aktgjykimin pasi që kishte diskutuar në hollësi meritat e lëndës.

Duke u mbështetur në këto që u thanë më sipër, Gjykata Supreme e Kosovës vendos si në dispozitiv.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**PKL.-KZZ. Nr. 23/2011**  
**Prishtinë**  
**27 dhjetor 2011**

**Kryetari i kolegjit:**

Procesmbajtësi:

---

**Charles L. Smith**  
Gjyqtar i EULEX-it

---

**Holger Engelmann**  
Zyrtar ligjor i EULEX-it

**Anëtarët e kolegjit:**

---

**Salih Toplica**  
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

---

**Martti Harsia**  
Gjyqtar i EULEX-it

---

<sup>1</sup> Gjykata Supreme e Kosovës, PKL.-KZZ. Nr. 114/2009, Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në lëndën penale kundër të pandehurës L. Xh.